



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2002/8 prot.

Datë 18.08.2026

V E N D I M

Nr.982/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Ismail Sheu	Kryetar
Donika Daci	Anëtar
Edvin Simo	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.08.2026 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Gentian Sadiku Pf, , në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-86199-05-20-2026, me objekt: “Blerje uniforma kundër zjarrit” me fond limit 5,833,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkoder.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Gentian Sadiku Pf, Extrabis SHPK , Malbertex SHPK , Grelek SHPK , Kledia-06 SHPK , në procedurën e prokurimit te sipercituar

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Shkoder.
Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 – Shkodër

Ankimues:

Grelek SHPK NIPT M12410008F dhe adresë: irane,
Rruga Irfan Tomini, Pallati nr 22/2, Sh2, K1 AP 19

BOE D&E dhe Victoria AL SHPK me Nipt
LK71804001C dhe K81531041T dhe adresë: Tiranë,

Rruga Muhamet Gjollës, Pallati 58, Shkalla 1, Ap 3, ane Kamez Rruga Thethi, Zona Kadastrale nr 2066, me nr. Pasurie 25/1/6, vol 34 faqe 147, Valias Kamëz, Tiranë

.Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se ankesat janë për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj ato duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 21-05-2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-86199-05-20-2026, me objekt: “Blerje

uniforma kundër zjarrit” me fond limit 5,833,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkoder..

II.2. Në datën datë 01-06-2026, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor më datë 12.06.2026, ka kryer rivlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Gentian Sadiku Pf	4 270 000 leke	Kualifikuar
2. Grelek SHPK	4 365 375 leke	Kualifikuar
3. Extrabis SHPK	4 375 000 lekë	Kualifikuar
4. BOE D&E dhe Victoria Al HPK	5 075 000 lekë	Kualifikuar
5. Malbertex SHPK	5 694 500 lekë	Kualifikuar
6. Kledia-06 SHPK	5 750 000 lekë	Kualifikuar
7. Bregu Company SHPK	5 775 000 lekë	Skualifikuar
8. Bajro Bross Shpk	Pa Oferte ekonomike	

II.4 Në datën17.06.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar Njoftim-Fituesi paraprak në sistemin e prokurimeve elektronike, për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 24.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6874 si dhe nr. Protokolli 2031/2026 datë 25.06.2026 i Grelek SHPK idhur me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik Gentian Sadiku Pf , në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2031/1 prot, datë 25.06.2026.

II.5.2. Autoriteti kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, më datë 02.02.2026 ka dërguar vendimin e KSHA nr.17011/3 prot., datë 29.06.2026 , protokolluar me tonën me nr.2031/2 prot., datë 29.06.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues Grelek SHPK. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj pasi nuk ka respektuar afatet e ankimit.

II.5.3. Autoriteti kontraktor, vendimin e KSHA nr.17011/4 prot., datë 30.06.2026 e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet shërbimit postar, kjo protokolluar me tonen nr.2031/3 prot., datë 02.07.2026.

II.6. Në datën 22.06.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6860 si dhe nr. Protokolli 2002/2026 datë 22.06.2026 i BOE D&E dhe Victoria AL. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e komisionit të vlerësimit të ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga Gentian Sadiku Pf, Extrabis SHPK , Malbertex SHPK , Grelek SHPK , Kledia-06 SHPK, dhe lenien te skualifikur te operatoreve ekonomik Barjo Bross SHPK dhe Bregu Company SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.

II.6.1. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr.2002/1 prot, datë 23.06.2026.

II.6.2. Autoriteti kontraktor nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, më datë 25.06.2026 ka dërguar vendimin e KSHA nr.16808/4 prot., datë 25.06.2026, protokolluar me tonën me nr.2002/2 prot., datë 25.06.2026, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues. Referuar vendimit të KSHA, rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe në përfundim ka vendosur mospranimin e saj.

II.6.3. Autoriteti kontraktor, vendimin e KSHA nr.322 prot., datë 02.02.2026, së bashku me informacion lidhur me procedurën e prokurimit objekt ankimi e ka përcjellë pranë KPP edhe nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr.341 prot., datë 04.02.2026 protokolluar me tonën me nr.300/3 prot., datë 06.02.2026

II.6.3 Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton se, janë paraqitur argumente nga operatorë ekonomikë të intersuar si BOE D&E dhe Victoria Al SHPK kjo me shkresën protokolluar me tonen Nr 2002/3 datë 29.06.2026, nga operatori Grelek SHPK me shkresën me Nr 2002/4 datë 29.06.2026 në kuptim të nenit 113 të LPP i ndryshuar .

II.7 Autoriteti Kontraktor Bashkia Shkoder ka dërguar pranë KPP shkresën me lëndë Informacion kjo me nr. 16808/5 datë 26.09.2026 protokolluar me tonën Nr 2002/5 datë 29.06.2026.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Grelek SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës Gentian Sadiku PF, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1. Në lidhje me pretendimet e ngritura në ankesën e operatorit ekonomik “Grelek SHPK me anë të së cilës kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik Gentian Sadiku duke cituar si me poshte:

“Nga vlerësimi vihet re që të gjithë operatorët kanë dorëzuar oferta të cilat janë kualifikuar teknikisht përveç kompanisë Bajro Bros. Operatorët pjesëmarrës kanë ofertuar mallra konform kërkesave të Autoritetit Kontraktor dhe kanë plotësuar, kërkesat teknike dhe ekonomike për mallrat objekt prokurimi përfshirë edhe Bregu Company e cila është skualifikuar vetëm për mungesë vetëm sigurimi oferte cka do të thotë që ka dorëzuar një oferte të vlefshme teknike dhe ekonomike. Nga përlllogaritja e këtyre ofertave OE Gentian Sadiku është oferte anomalisht e ulët. Kështu shuma e ofertave të vlefshme teknike dhe ekonomike të Operatorëve : Gentian Sadiku, Grelek, Extrabis, D&E, Malbertex, Kledia -06 dhe Bregu Company është 35,304,875. Mesatarja = 5,043,553.571 85% e mesatares = 4,287,020.53 OE pjesëmarrës Gentian Sadiku është me e ulët se 85% e mesatares se ofertave të vlefshme. Sipas nenit 82 pika 4 VKM 285/2021 të ndryshuar. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: - Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur; - Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

III.1.1. Në nenin 93 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoritetet ose entet kontraktore vërejnë se oferta për punët, furnizimet ose shërbimet është anomalisht e ulët, i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë me shkrim dhe brenda tri ditëve pune shpjegime për çmimin ose kostot e propozuara në ofertë.

2. Shpjegimet e përmendura në pikën 1 jepen veçanërisht për:

a) anën ekonomike të procesit të prodhimit, të shërbimeve të ofruara ose të metodës së ndërtimit;

b) zgjidhjet teknike të përzgjedhura dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm që ka ofertuesi për furnizimin e produkteve ose shërbimeve ose për kryerjen e punës;

- c) origjinalitetin e punës, furnizimeve ose shërbimeve të propozuara nga ofertuesi;
 ç) pajtueshmërinë me detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fushën e mjedisit, në fushën sociale dhe të punës;
 d) mundësinë e ofertuesit për të marrë ndihmë shtetërore.

3. Autoriteti ose enti kontraktor vlerëson informacionin e dhënë, duke u konsultuar me ofertuesin. Ai mund ta refuzojë ofertën kur, edhe pas shqyrtimit të provave të dhëna nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj.

4. Nëse një autoritet kontraktor konstaton se një ofertë është anomalisht e ulët për shkak se ofertuesi ka marrë ndihmë shtetërore, oferta mund të refuzohet vetëm për këtë arsye, vetëm pas konsultimit me ofertuesin, nëse ky i fundit nuk mund të provojë, brenda një afati kohor të përcaktuar nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet të jetë të paktën 3 ditë pune, që ndihma është marrë në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, autoritetet ose entet kontraktore refuzojnë pa kërkuar shpjegime një ofertë, e cila është konstatuar anomalisht e ulët.”

III.1.2. Në nenin 82/4 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

4. Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme:

- Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur;

- Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit/ët, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 93, të LPP-së.

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë: $O - \text{Oferta MO} - \text{Mesatarja e ofertave të vlefshme}$ $N - \text{Numri i ofertave të vlefshme}$ $PR (Zm) - \text{Zbritje e mundshme MO}$
 $= O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$ $PR = 85 \% Mo$ $Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR \dots$
 rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

III.1.3. Në Kreun II, “Kufijtë monetarë në sektorin klasik” të VKM-së nr.291, datë 15.05.2024 “Për përcaktimin e kufijve monetarë në procedurat e prokurimit publik”, përcaktohet se:

“1. Kufiri i lartë monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 603 000 000 (gjashtëqind e tre milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 16 000 000 (gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë.

2. Kufiri i ulët monetar në sektorin klasik është, si më poshtë vijon: a) Për procedurat e prokurimit për punë publike, e barabartë ose më e madhe se vlera 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekë; b) Për procedurat e prokurimit për mallra, shërbime dhe konkurset e projektimit, e barabartë ose më e madhe se vlera 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë.

III.1.4. Referuar Dokumenteve Standarde të Procedurës së Prokurimit, Vlerësimi i Ofertave, citohet:

Korrigjimi i gabimeve aritmetike dhe ofertave anomalisht të ulëta

1. Autoriteti Kontraktor kontrollon ofertat e paraqitura nëse kanë gabime aritmetike. Nëse ofertat rezultojnë me gabime aritmetike, autoriteti i korrigjon këto gabimesi më poshtë:

Nëse ka ndonjë mospërputhje midis çmimit për njësi dhe çmimit total, që rezulton nga shumëzimi i çmimit të njësisë me sasinë, çmimi i njësisë mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

Nëse ka ndonjë mospërputhje tek çmimi total, kur totali është shuma ose diferenca e nëntotaleve, çmimi i nëntotalit mbizotëron dhe çmimi total korrigjohet në bazë të tij. Në këtë rast, do të korrigjohet edhe shuma në fjalë, e cila ka lidhje me gabimin.

Nëse ka ndonjë mospërputhje ndërmjet shumës në fjalë dhe shumës në shifra, mbizotëron shuma në fjalë. Bën përjashtim nga ky rregull situata kur, shuma në fjalë ka mospërputhje me shumën në shifra, ndërkohë që kjo e fundit nuk ka gabime aritmetike në përlllogaritjen e zërave të ofertës.

Në çdo rast, Ofertat me gabime aritmetike refuzohen kur:

- shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më shumë se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar;

- shuma absolute e të gjitha korrigjimeve është më pak se 2%, por nuk pranohet korrigjimi nga ofertuesi.

2. Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% të fondit limit të përlllogaritur.

Në rast kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93 të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve.

Në procedurat e prokurimit me vlerë mbi kufijtë e lartë monetarë, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duhet të kërkojë operatorit ekonomik të paraqesë brenda tre ditëve pune, shpjegime të çmimit ose kostove të propozuara në ofertë, në përputhje me nenin 93 të LPP-së dhe të vlerësojnë informacionin e dhënë, në konsultim me ofertuesin, në përputhje me dispozitat e këtij neni.

Në çdo rast, ofertuesi ka detyrimin të justifikojë dhe dokumentojë me prova me shkrim, shpjegime për elementin/elementët specifike të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 93 të LPP-së.

2.1 Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

III.1.5. Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se *ratio legis est anima legis*, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1 kërkon shprehimisht që, *ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.*

Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se operatorët ekonomikë janë njoftuar në përputhje me parashikimet e ligjit për prokurimin publik në lidhje me vlerësimin e ofertave nga KVO, i cili nga shqyrtimin i arsyeve të skualifikimit në procedurë konstaton, se AK ka kryer vlerësim duke kualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë të sukseshëm në përmbushje të kriterëve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit

Referuar Vlerësimit të ofertave ekonomike në SPE rezulton se autoriteti Kontraktor ka skualifikuar ofertat e operatorëve ekonomikë Bregu Company SHPK dhe Bajro Bross Shpk Pa Oferte ekonomike.

III.1.6. Komisioni Prokurimit Publik citon se në nenin 82/4 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të VKM Nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet në pikën 4 shprehimisht se: - **Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.** Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë: **O - Oferta MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme**
N - Numri i ofertave të vlefshme PR (Zm) – Zbritje e mundshme MO = O1 + O2 + O3 + ...
On / N PR = 85 % Mo Vlera e ofertave të vlerësuar <.. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët. Komisioni nga shqyrtimi i ankesës, vëren se operatori ekonomik ankimues në përlogaritjet e tij ka përfshirë në mbledhje të ofertave dhe ofertën e skualifikuar në rastin konkret atë të Bregu Company. KPP sqaron se nga ofertuesit e kësaj procedure rezultojnë të jënë 8 gjithsej ku 6 prej tyre të kualifikuar dhe 2 të skualifikuar. Nga përlogaritja e bere sipas formule se sipercituar ku mblidhen ofertat e tyre ,6 të kualifikuar dhe me pas përpjestohet në numrin e të kualifikuarve dhe, nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme atëherë kjo oferta do të rezultonte anomalisht e ulët. Komisioni, referuar fakteve, kreu hetim administrativ dhe konstatoi, se procedura e prokurimit objekt ankimi është Procedurë e Hapur e Thjeshtuar, Mesatarja e 6 Ofertave të vlefshme: $4375000 + 5694500 + 4270000 + 4365375 + 575000 + 5075000 = 29529875 : 6 = 4921645.8$
 $85\% \text{ e } 4921645.8 = 4.183,398$. Referuar raportit të auditit operatori ekonomik Gendian Sadiku Pf ka ofertuar me vlerën 4270000

Për sa analizuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se oferta e operatorit ekonomikë “Gendian Sadiku Pf nuk rezulton vlerë anomalisht e ulët.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk qendrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e BOE D&E dhe Victoria AL SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Extras” SHPK, me pretendimin se “II. Mbi nevojën për verifikimin e operatorit ekonomik EXTRABIS Nga analiza e dokumentacionit të procedurës, natyrës së objektit të prokurimit dhe informacionit publik të disponueshëm për operatorin ekonomik EXTRABIS, krijohen indicie të arsyeshme që kërkojnë verifikim të plotë në lidhje me përmbushjen e kriterëve të përcaktuara në pikat 2.3.2, 2.3.3 dhe 2.3.4 të Dokumenteve të Tenderit. Objekti i procedurës është Blerje uniforma kundër zjarrit, të cilat sipas VKM nr. 1153, datë 24.12.2020, përbëjnë produkte profesionale të mbrojtjes individuale për personelin operacional të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin. Në mungesë të aksesit në dokumentacionin e plotë të paraqitur nga ky operator ekonomik në procedurë, ankimuesi nuk mund të pohojë në mënyrë përfundimtare nëse dokumentacioni është ose jo i plotë. Megjithatë, kërkon nga KPP administrimin dhe verifikimin e plotë të dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik EXTRABIS për përmbushjen e kriterëve sipas pikave 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4 dhe specifikimeve teknike të DST-së. Nga verifikimet e kryera në burime publike të lidhura me produktet që tregtohen/publikohen nga operatori ekonomik EXTRABIS, rezulton se modele të tilla si FYRHOOD? 50 Antiflash Knit Head (Broad Skirt), FYRHOOD? 50 Antiflash Knit Head (Narroë Skirt) dhe 19-992 Fire Fighting Balaclava Cool Head (2-ply), paraqesin karakteristika teknike dhe përbërje materiale që kërkojnë verifikim të posaçëm në raport me kërkesat e përcaktuara në DST dhe VKM nr. 1153. Këto të dhëna nuk paraqiten nga ankimuesi si provë përfundimtare e mospërputhjes së ofertës së operatorit ekonomik EXTRABIS, pasi ankimuesi nuk disponon dokumentacionin e plotë të dorëzuar prej tij në procedurë. Megjithatë, ato përbëjnë indicie të arsyeshme që e bëjnë të domosdoshëm verifikimin e plotë nga Autoriteti Kontraktor dhe KPP. Në këtë drejtim, Autoriteti Kontraktor nuk duhet të mjaftohet vetëm me deklarime formale, por duhet të verifikojë nëse produktet e ofertuara janë realisht ato që përmbushin specifikimet teknike të procedurës, certifikimet e kërkuara dhe standardet e zbatueshme për PPE të kategorisë III. Nëse gjatë verifikimit rezulton se qoftë edhe një prej elementeve të uniformës zjarrduruese, konkretisht xhaketa, pantallonat, dorashkat, helmata, çizmet ose kapuçi, nuk përmbush kërkesat e DST-së dhe VKM nr. 1153, atëherë operatori ekonomik EXTRABIS duhet të skualifikohet për mosplotësim të kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike. Për pasojë, kërkojmë që KPP të verifikojë vlefshmërinë dhe plotësinë e deklaramit të paraqitur në Shtojcën 9 të Dokumenteve të Tenderit. Nëse rezulton se deklarimi nuk mbështetet nga dokumentacion teknik dhe certifikues i plotë, i qartë dhe i verifikueshëm, atëherë ky fakt duhet të konsiderohet shkak skualifikimi për mosplotësim të kriterëve sipas pikave 2.3.3 dhe 2.3.4, si dhe të specifikimeve teknike të procedurës. Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, operatori ekonomik ankimues nuk parashtroi fakte të bazuara, se cilat nga specifikime teknike nuk plotësohen nga operatori ekonomik “Extrabis” SHPK dhe se ku bazohet në mosplotësimin e kriterëve nga operatori ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi

III.2.2. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit të afateve) edhe *“elementet e domosdoshme të ankesës”* sipas përcaktimeve të nenit 48, *“Kushtet formale të ankesës”, pika 3: - Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni*

III.2.3. Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicie dhe argumente ose dokumentacionin përkatës se cilin nga specifikimet për këta artikuj nuk plotësohen sipas atyre të përcaktuar në DST dhe se në çfarë nuk plotëson kriteret e ankimuar, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.4 . Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve apo specifikimeve teknike nga ana e operatorëve të tjerë ekonomikë. Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kritereve jo duke cituar se janë thjesht indicie.

III.2.5. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesëmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.6. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimuesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efikasitetin e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim pro aktiv, në krah të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatori pjesëmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin

e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion re-aktiv, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimuesit. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është në drejtë të operatorëve ekonomikë të paraqesin pretendime mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, duke justifikuar kështu interesin e tyre të ligjshëm, por ndërkohë, operatorët ekonomikë nuk mund të parashtrojnë pretendime a-priori duke mos identifikuar asnjë element konkret brenda kriterëve të veçanta të kualifikimit, si edhe duke mos dhënë asnjë provë apo argument se ku mbështet pretendimet e tij. Vetë Kodi i Procedurave Administrative ka parashikuar në nenin 82 pika 1 të tij se *“Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj Një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se “onus probandi incumbit actori” se barra e provës bie mbi ankuesin.* Gjithashtu, KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar të gjitha elementet procedurale, përmes të cilave garantohet e drejta e informimit të operatorëve ekonomikë në kuadër të zhvillimit të procedurave të prokurimit publik.

III.2.7. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementeve përbërëse të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.8. KPP është paraparë nga ligji si një quasi gjykatë. Si e tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin, se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme. Për sa referuar më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme, ndaj pretendimet e BOE D&E dhe Victoria AL” SHPK, për mos përmbushjen nga operatori ekonomik “Extrabis” SHPK të specifikimeve teknike për artikujt (cituar më sipër) dhe kriterëve 2.3.2, 2.3.3, 2.3.4 nuk do të merren në shqyrtim nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

III.3 Lidhur me pretendimet e tjera të BOE D&E dhe Victoria AL” SHPK i cili kërkon skualifikimin e ofertave së paraqitura nga operatori Gentian Sadiku Pf, Malbertex SHPK , Grelek SHPK , Kledia-06 SHPK, dhe lenient e skualifikur te operateve enkomomik Barjo Bross SHPK dhe Bregu Company SHPK në procedurën e sipërpërmendur të prokurimit.,. nuk qëndrojnë, pasi lidhur me gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP operatori

ekonomik “Extrabis” SHPK, SHPK, do të mbetet e kualifikuar, ndaj trajtimi i pretendimeve të ankimuesit në lidhje me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Gentian Sadiku Pf, Malbertex SHPK , Grelek SHPK , Kledia-06 nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi për prokurimin publik, interesi i ligjshëm i drejtpërdrejtë i ankimuesit, nuk ka sesi të dëmtohet nga suktesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në këtë procedurë prokurimi, pasi edhe në hipotezën që këto pretendime do të pranoheshin, ai sërish nuk do të mund të shpallej fitues i kontratës objekt - prokurimi, duke qenë se në renditjen përfundimtare, para tij qëndron një tjetër operator ekonomik i kualifikuar.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Grelek” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-86199-05-20-2026, me objekt: “Blerje uniforma kundër zjarrit” me fond limit 5,833,333.00 Lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 01-06-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Shkoder.
 2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE D&E SHPK dhe Victorial AL SHPK në procedurën e si me sipercituar.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në buxhetin e shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Grelek” SHPK dhe BOE D&E SHPK dhe Victorial AL SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Donika Daci

Anëtar
Edvin Simo

Kryetar
Ismail Shehu

